

KËRKESAT LIGJORE PËR PARAPAKETIMET

Informacion për operatorët ekonomikë

Kjo broshurë jep informacion për parapaketimet dhe kërkesat metrologjike në lidhje me sasinë neto, sasinë nominale, mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në to, për të garantuar saktësinë e kapacitetit mbajtës të tyre.

Pse duhen kërkesat metrologjike për parapaketimet?

Një gamë e gjerë produktesh blihen të parapaktuara. Të tilla janë: ushqimet, pijet, detergjentët, produktet kozmetike, bojrat dhe produktet plehëruese, kimikatet etj. Për këtë arsye, transparenca dhe saktësia e kapacitetit mbajtës të tyre ka rëndësi thelbësore për mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve dhe garantimin e konkurrencës së ndershme në treg. Për të siguruar këto, ekzistojnë rregullime ligjore të posaçme, të cilat duhet të njihen dhe zbatohen nga operatorët ekonomikë. Nga ana tjetër, edhe konsumatorët duhet të jenë të mirinformuar për këto kërkesa, me qëllim që të jenë të aftë të mbrojnë të drejtat e tyre. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ushtron kontrolli çdo vit, në rreth 100 subjekte pakues dhe/ose prodhues të produkteve të parapaktuara.

Ku mund të merret informacion për parashikimet ligjore:

Kërkesat për prodhimin dhe tregtimin e parapaketimeve janë të përcaktuara në rregulloren "Për Parapaketimet" e miratuar me VKM-në nr. 443/2021, si edhe ligjin nr. 126/2020 "Për metrologjinë". Ato parashikojnë kërkesat metrologjike ligjore ndaj përmbajtjes së sasisë neto, mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në parapaketime, si edhe metodat referuese për kontrollin e sasisë neto të tyre.

Çfarë konsiderohet parapaketim?

Parapaketimi është kombinimi i një produkti dhe një pakëtimi individual në të cilin është parapaketuar. Një produkt është i parapaketuar kur:

- vendoset në një pakëtim, të çfarëdo natyre, pa qenë blerësi prezent
- sasia e produktit që përmban pakëtimi ka një vlerë të paracaktuar
- sasia e produktit nuk mund të ndryshohet pa u hapur pakëtimi ose pa u nënshtuar një modifikimi të perceptueshëm. Përfashtohen nga kjo kategori e përgjithshme produktet që kanë për qëllim shitjen në dyqanet pa taksa doganore.

KUJDES!

Parapaketimi nuk përfshin:

- ushqimin e pakëtuar në ambientet e shitjes me kërkesë të konsumatorit;
- ushqimin që shitet nga ambientet në të cilat është pakëtuar ose nga një automjet i përdorur nga ambalazhuesi.

Disa përkufizime të rëndësishme:

Sasia nominale (pesha ose volumi nominal) e përmbajtjes së një parapaketimi, është pesha ose volumi i deklaruar në parapaketim, pra **sasia që parapaketimi deklarohet se përmban**.

Përmbajtja aktuale apo **sasia neto** është **sasia (pesha ose volumi) e produktit që në fakt përmban parapaketimi**.

✓ Shenja e konformitetit

- përbën një garanci nga pakëtuuesi ose importuesi që parapaketimi i plotësuar kërkesat metrologjike të sasisë neto të produktit;
- duhet të jetë të paktën 3 mm e lartë dhe e vendosur në të njëjtin hapësirë me treguesin e masës ose volumit nominal;
- duhet të ketë formën, përmasat dhe paraqitjen grafike të mëposhtues:



KUJDES!

- Për parapaketimet mbi 10 kg ose 10 litra nuk vendoset shenjë konformiteti.
- Gabimet negative të lejuara të parapaketimeve janë të mirëpërcaktuara në VKM-në nr. 443/2021.
- Asnjë parapaketim që ka një gabim negativ më të madh se dyfishi i gabimit negativ të lejuar, nuk mund të mbajë shenjë "e" të konformitetit.

✓ Diapazonet e detyrueshme

Diapazonet e sasive nominale të përmbajtjeve të parapaketimeve për shitjen e disa produkteve specifike, janë të mirëpërcaktuara në VKM-në nr.443/2021.

Shembull:
Verë e pagazuar kur shitet në sasi nga 100 mL deri në 1500 mL, lejohet të shitet e parapaketuar vetëm në 8 sasi nominale: mL: 100 – 187 – 250 – 375 – 500 – 750 – 1000 – 1500"

- Përkufizimi i këtyre produkteve specifike është gjithashtu i përcaktuar në VKM-në nr. 443/2021, për të shmangur paqartësitë.

Shembull:
Verë e pagazuar: verë prej rrushi të freskët, përfshirë verërat e pasuruar me alkoool; mushk rrushi: Kodi sipas nomenklaturës së mallrave dhe tarifa doganore (Kodi NC 2204).

- Në rastin e pakëtimin të shumfishtë, që përmban dy ose më shumë parapaketime që shiten individualisht, sasinë nominale duhet të zbatohen për çdo parapaketim individual.
- Nëse parapaketimi përbëhet nga dy ose më shumë pakëtime individuale që nuk shiten individualisht, sasinë nominale zbatohen në parapaketim.

! Këto produkte të specifikuar si më sipër, vendosen në treg dhe ofrohen në shitje vetëm nëse janë pakëtuar sipas sasive nominale të përcaktuara.

✓ Rregullat e mbishkrimeve në parapaketime

- Çdo parapaketim i bërë në përputhje me VKM-në nr. 443/2021, duhet të mbajë mbi pakëtim mbishkrimet e sasisë nominale;
- Sasia nominale duhet të deklarohet në **kilogram, gramë, litër, centilitër ose mililitër** dhe do të shënohet në shifra;
- Madhësia e mbishkrimit varet nga sasia nominale dhe është e përcaktuar (psh. 6 mm lartësi nëse sasia nominale kalon 1000g ose 100 mL);
- Parapaketimi duhet të përmbajë edhe një markë apo mbishkrim që identifikon pakëtuuesin ose personin që rregullon pakëtimin ose importuesin;

! Të gjitha mbishkrimet e mësipërme duhet të vendosen në mënyrë që të mos dëmtohen ose hiqen, të jenë lehtësisht të lexueshme dhe të dukshme në kushte normale të paraqitjes.

✓ Detyrimet e operatorëve ekonomikë

- Pakëtuuesi ose importuesi është përgjegjës për përputhshmërinë e parapaketimeve me kërkesat metrologjike dhe vendos në treg vetëm produkte me parapaketim konform kërkesave përkatëse.
- Praktikisht, pakëtuuesi dhe/ose prodhuesi, ka dy mënyra për të garantuar që sasia neto e produktit përputhet me sasinë nominale të shënuar në pakëtim:
 - Sasia neto e produktit duhet të matet ose kontrollon sipas masës dhe volumit nën përgjegjësinë e tij;
 - ose
 - Kur përmbajtja aktuale nuk matet, pakëtuuesi zbaton sistemin e tij të kontrollit të prodhimit të parapaketimit;

- Pakëtuuesi dhe/ose prodhuesi duhet të miratojë paraprakisht sistemin e kontrollit të prodhimit të parapaketimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë;
- Pakëtuuesi mban në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Inspektoratit Shtetëror të Mbiqyrtjes së Tregut, dokumentet që përmbajnë rezultatet e kontrolleve të tilla;
- Importuesi, në vend të matjeve dhe kontrolleve siguron prova të tjera, të tilla si:
 - deklaratën e pakëtuuesit (prodhuesit);
 - dokumente që përmbajnë rezultatet e kontrollit/testimit që ai zotëron;
 - të gjitha garancitë e nevojshme që e mundësojnë atë të marrë përgjegjësinë;
- Pakëtuuesi ose importuesi, kur konstaton se parapaketimet e vendosura në treg prej tij nuk përmbushin kërkesat ligjore të përshkruara, merr masat e duhura për mbrojtjen e konsumatorit në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Mbiqyrtjes së Tregut.

✓ Kontrolli metrologjik ndaj parapaketimeve

- Përpara vendosjes në treg:
 - Kontrolli për verifikimin paraprak të përputhshmërisë së parapaketimeve me kërkesat metrologjike kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.
 - Kontrolli kryhet gjatë procedurës së miratimit të sistemit të kontrollit sasior dhe monitorimit periodik të tij, duke marrë mostra në ambientet e pakëtuimit (në linjën e pakëtimin).
- Pas vendosjes në treg:
 - Inspektimi për përputhshmërinë e produkteve të parapaktuara me kërkesat metrologjike kryhet nga Inspektorati Shtetëror për Mbiqyrtjen e Tregut;
 - Inspektimi kryhet për të gjithë pakëtuuesit, importuesit dhe rrjetin e tregtimit pa kufizime, duke marrë mostra në ambientet e tyre.
 - Në rast konstatimi të tregimit të produkteve të parapaktuara në kundërshtim me kërkesat metrologjike, merren masa përkatëse duke filluar nga vendosja e gjobave deri në ndalimin i vendosjes në treg apo heqjen nga tregu të këtyre produkteve.

*Kontrolli me marrje mostre do të bëhet në përputhje me metodat e planuara të inspektimit të pranimit të cilësia.



Publikim i mundësuar nga projekti "Mbështetje për Negociatat e Anëtarësimit në Kapitujt Ekonomikë të Acquis" (SANECA) financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim dhe zbatuar nga GIZ Shqipëri.

Përmbajtja e kësaj broshure ka karakter informues. Detyrime ligjore të plota jepen në aktet ligjore të përmendura në brendësi të broshurës.

